



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 14
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 03 qershor 2015, në orën 12:30.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Njomza Emini, Fikrim Damka, Fadil Beka, Besa Baftiu, Time Kadrijaj, Hatim Baxhaku, Shukrije Bytyçi.

Munguan: Adem Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Të ftuar: Arban Abrashi, ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale; Basri Ibrahim, kryeinspektor i Inspektoratit të Punës; Sami Saliu, drejtor i Departamentit të Pensioneve; Naser Avdiu, kryetar i Sindikatës së Pensionistëve të Kombinatit “TREPÇA” Gani Musliu, nënkryetar i sindikatës së kombinatit “TREPÇA”.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 27.05.2015;
3. Takim me përfaqësuesit e pensionistëve të kombinatit “TREPÇA”;
4. Takim me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-MPMS, z. Arban Abrashi;
 - Temë diskutimi: Zbatimi i Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat pensionale të financuara nga shteti.
5. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 27.05.2015

Kryetarja, konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 27.05.2015, pa vërejtje.

3. Takim me përfaqësuesit e pensionistëve të kombinatit “TREPÇA”

Kryetarja – Fillimisht, më lejoni t’i falënderojë përfaqësuesit e Sindikatës së Punëtorëve të kombinatit “TREPÇA”. Siç jeni në dijeni, ne kemi pranuar një kërkesë nga kjo sindikate. Në këtë mbledhje i kemi prezentë përfaqësuesit e sindikatës të kombinatit “TREPÇA” për t’i dëgjuar për së afërmi kërkesat dhe shqetësimet tyre lidhur me pensionistët e kësaj sindikate, siç janë çështjet e mospranimit të pensioneve për pensionistët të cilëve nuk iu vazhdohet puna, e të cilët nuk janë as në pension. Pra, momentalisht janë nën moshën 50 vjet dhe në këtë moment ata nuk gëzojnë asnjë të drejtë, ndërsa më parë e kishin këtë të drejtë. Në marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe kombinatit “Trepça” i është pranuar stazhi për pensione të parakohshme, prej datës 20.06.1990 deri më 01.07.1999, në vazhdim 2004. Në këtë marrëveshje, thuhet se për pensionistët deri në në moshën 65 vjeç, ndërsa nëse kanë një stazh pune 15 vjet pandërprerë, pensionistët, gjithashtu minatorëve dhe anëtarëve të familjes së ngushtë, t’u pranohet edhe sigurimi shëndetësor. Përfaqësuesit e këtyre pensionistëve i kemi këtu dhe ata do t’i shtrojnë kërkesat e veta. Unë ua jap fjalën dhe secili le të prezantohet dhe t’i parashtojë këto kërkesa, që në takimin e radhës me ministrin t’i parashtojme ne këto kërkesa si dhe të shqyrtojmë mundësinë e zgjidhjes së tyre.

Naser Avdiu - Ju faleminderit kryetare, përshëndetje për të gjithë deputetët. Me të vërtetë, ndihemi mirë që na keni dhënë mundësinë që para jush të prezantojmë kërkesat, si dhe shqetësimet e sindikatës sonë lidhur me problemet që ballafaqohen pensionistët e kombinatit “Trepça”. Ne i kemi adresuar kërkesat tona pothuajse në të gjitha institucionet, duke përfshirë edhe Presidentin lidhur me pensionistët minatorë të parakohshëm, si dhe ata të cilët kanë qenë edhe më herët me stazh të beneficuar, t’ju paguhen pensionet e parakohshme, të cilët kanë edhe probleme shëndetësore. Po ashtu, 72 pensionistë të cilët kanë mbetur të parakohshëm nën moshën 50 vjet, kanë mbetur jashtë pagesës, me marrëveshje apo me udhëzim administrativ që ka qenë më herët, në kohën e UNMIK-ut. Ata kanë gëzuar këtë të drejtë deri në aprovimin e këtij ligji. Ne si shoqatë e minatorëve që i mbrojmë të drejtat e tyre, kemi arritur një marrëveshje, në sajë të ndihmës së ministrisë dhe qeverisë, që iu ka pranuar ky stazh i punës, prej periudhës 1989-1990 dhe 1990-2004, të cilëve iu jemi shumë falënderues. Kemi biseduar me ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale se në ligj thuhet që, ata të cilët janë nën moshën 50 vjet, nuk ka mundësi t’ju jepet pagë. Ne kemi biseduar edhe në të kaluarën me ministrin, që të krijohet mundësia, sepse nuk është shumë e madhe, pasi që janë 72 persona. Ata brenda vitit mbesin vetëm 27 persona, për arsye se të tjerët arrijnë moshën mbi 50, mandej fillon pensioni i rregullt, një çështje tjetër është edhe kontrolli shëndetësor, për të cilin kemi problem sidomos në Prishtinë, kurse në Mitrovicë, falë ndihmës së përfaqësuesit të Ministrisë së Shëndetësisë, nuk kemi probleme të tilla. Kemi bërë kërkesë në Ministri të Shëndetësisë, por ende nuk kanë kthyer përgjigjeje. Me ish-ministrin e Shëndetësisë, Ferid Aganin, kemi pasur mirëkuptim për këtë çështje.

Kryetarja - Te mbrojtja shëndetësore, minatorët e kanë pasur institutin e vet të shëndetit.

Naser Avdiu - E kanë pasur më herët, por tani është një institut me një staf të vogël vetëm për punëtorët që janë në marrëdhënie pune, jo edhe për pensionistët. Ne kemi kërkuar që t'ju mundësohet edhe pensionistëve. Kontributin e minatorëve ju të gjithë e dini dhe nuk dëshiroj të iu marr shumë kohë. Kërkojmë që minatorët t'i trajtojnë si të veçantë, në bazë të kontributit që e kanë dhënë, edhe në shëndetësi, edhe për çështjen e pensioneve të parakohshme të gjejnë një zgjidhje, sepse minatorët kanë probleme me sëmundje të ndryshme, si kancer ku nuk kemi pasur mundësi t'i ndihmojmë, përveç një rasti, ish- ministri, z. Ferid Agani, ia ka mundësuar shërimin kolegut tim, i cila ka pasur dëshirë të jetë këtu sot, por nuk ka mundur. Kemi edhe raste të tjera, por nuk kemi mundësi. Po ashtu, kemi kërkuar edhe nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për ta ndarë një buxhet të vogël, presim edhe një takim me ministrin Abrashi, kështu që kërkoj prej institucioneve që minatorëve t'u jepen kontributet që iu takojnë, ju faleminderit.

Kryetarja - Ju faleminderit që keni gjetur kohë të merrni pjesë në këtë takim. Ne do të bisedojmë me ministrin drejtpërdrejt, por edhe për çështje që i theksuat, Komisioni ynë i mbështet këto ministri, por edhe i monitoron, edhe çështjen e shëndetit të minatorëve, të këtyre që janë në pension dhe të atyre që janë afër pensionimit. Të gjithë e dimë se minatorët kanë mjaft probleme shëndetësore, për shkak të punës së rëndë, nga sëmundjet e ndryshme kancerogjene, të frymëmarrjes, kardiovaskulare etj. Tani e ka fjalën nënkryetari i shoqatës.

Gani Musliu - Kryetari i përmendi problemet të cilat po ballafaqohemi kohëve të fundit. Nëse më lejohet një sqarim rreth çështjes së shëndetësisë, librezat e shoqatës sonë në QKUK nuk i marrin parasysh. Ne insistojmë që këto librezat të pranohen, por librezat nuk iu lëshojmë të tjerëve, pos anëtarëve tanë që kanë qenë ish-punëtorë të minierave. Gjendja e minatorëve është shumë e rëndë. Këta kërkojnë t'u vazhdohet pensioni ose të kthehen në punë. Kohëve të fundit, me një marrëveshje interne e cila nuk është e garantuar, miniera iu jep një shumë prej 30 eurosh. A mund të jetohet me këtë shumë? Nëse punojnë diku për të nxjerrë një mëditje, mund të ndodh që nëse i shkon pagesa përmes bankës, iu ndalet. Pra, një absurditet që me 135 euro që i marrin e kanë të ndaluar të punojnë. Kush mund të jetojë me një shumë të tillë? Kemi pasur probleme sa herë që kanë ndalë pensionet e rregullta, të cilat i kanë gëzuar me marrëveshje. Kemi shpresë se përmes jush si Komision, të gjejmë mirëkuptim. Besoj se do të gjejmë përkrahje padyshim, jo vetëm tek ju, por edhe në ministri. Të paktën, këto librezat të pranohen, se po bëmë qesharak, i paguajnë tri 3 euro në vit, mos të flasim për vuajtje që i dimë të gjithë. Mos t'u marrim edhe juve kohë, por përpos kësaj edhe stazhi i beneficuar, edhe këta që kanë dalë në pension, nuk iu është llogaritur stazhi. Përpara ka qenë e rregulluar me ligj, kush ka punuar në minierë, kanë qenë të klasifikuar në disa grupe, grupi i cili ka punuar 12 muaj ka marrë 14 muaj stazh, grupi tjetër ka punuar 14 muaj, ka marrë 16 muaj stazh të beneficuar. Momentalisht, të gjithë ata që kanë dalë në pension, po ashtu edhe unë që jam në pension, nuk e gëzojmë këtë stazh të beneficuar. Kartelat kanë qenë për secilin person të punësuar, por kanë qenë të fshira në kohën e regjimit serb dhe kanë mbetur të padefinuara. Në këtë rast, strukturat udhëheqëse të kombinatit, duhet të punojnë më shumë. Në këto momente për neve më të rëndësishme janë librezat shëndetësore dhe çështja e pensionit të parakohshëm të kolegëve tanë.

Kryetarja – Sigurisht, duhet ndonjë marrëveshje. Ligji për sigurime shëndetësore ende nuk ka filluar të zbatohet.

Naser Avdiu - Ne kemi takuar sot disa minatorë që janë në pension të parakohshëm. Ata kërkojnë ose të na bëjnë pagesën sikur të pensionistëve tjerëve, ose të na kthejnë në vende të punës, e për punë ata nuk janë, edhe pse janë nën moshën 50 vjeç.

Kryetarja - E kemi kohën e limituar, për shkak të ardhjes së ministrit, nëse dikush ka ndonjë pyetje urdhëroni.

Time Kadrijaj - Ne e kemi shqyrtuar shkresën që e keni adresuar tek komisioni parlamentar. Në këtë Komision kur është amendamentuar ky ligji për pension, kemi qenë 3 anëtarë që jemi ende pjesë e këtij Komisioni, posaçërisht kemi qenë të kujdesshëm që të mbrohen interesat e minatorëve të Trepçës dhe minatorëve të tjerë. Ne në ligj e kemi përfshirë pensionin e parakohshëm dhe kemi insistuar që të gjithë ata që kanë marrë ato pensione t'u paguhet dhe asnjë të mos hiqet nga pensionet e parakohshme, pavarësisht edhe nëse ka kosto buxhetore shtesë. Po ashtu, kemi menduar thjesht që ky nen i caktuar është duke u zbatuar, por fatkeqësisht me Ligjin për pensione të financuara nga shteti, përpos këtij neni ku përfshihen të drejtat, beneficionet e minatorëve të Trepçës, nuk kanë filluar të zbatohen edhe disa nene të caktuara, që na kanë shtyrë për këtë shkak të ftojme në Komision për raportim ministrin e Punës dhe Mirëqenie Sociale, sepse ne e dimë që ka pasur presione të mëdha për kalimin e këtij ligji të pensioneve. Ne e kemi ditur se vlera e pensioneve është vlerë që duhet ta gëzojnë të gjithë pensionistët, por meqenëse na ka kushtëzuar, që për shkak të buxhetit duhet të jenë këto vlera, ne është dashur të pajtohemi, për shkak se janë referuar disa marrëveshja ndërkombëtare që Ministria e Punës është dashur t'i lidhë, sepse mosmiratimi ka qenë pengesë. Kurse për shëndetësi, prapë unë mendoj që e keni mjekësinë e punës që funksionin në kuadër të minierave, ku ju mund të organizoni vizita të rregullta, por kjo nuk do të thotë se nuk keni të drejtë të kërkonit shërbime shëndetësore edhe me të larta, qoftë edhe në QKUK. Kjo është dashur të bëhet me marrëveshje paraprake, pra të rregullohet në mes të institucioneve shëndetësore dhe juve si minatorë apo edhe ministrisë, që ndërkohë, derisa të fillojë Ligji për sigurime shëndetësore, duhet të keni të drejtë t'i merrni ato shërbime shëndetësore. Ne kemi menduar se Ligji për sigurime shëndetësore do të fillojë të zbatohet prej janarit 2015, por fatkeqësisht ende nuk ka filluar dhe po presim që të zbatohen dhe të bëhet një zgjidhje adekuate, ndërsa për kërkesat tjera që janë të parapara me ligj dhe nuk po zbatohen, ne do t'i diskutojmë me ministrin dhe e keni përkrahjen tonë si komision parlamentar.

Kryetarja - Faleminderit, edhe unë po mendoj që kjo e drejtë e juaja mund të bazohet në Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, tek neni 10 pika 2.4 dhe pika 2.7 e këtij neni, nëse elaborohen pak më mirë, këta 72 punëtorë mund ta gëzojnë pensionin e parakohshëm.

Besa Baftiu - Përshëndetje për përfaqësuesit e Sindikatës së Pensionistëve të kombinatit "Trepça", njëherazi kërkoj falje për vonesën, nuk munda prej fillimit ta përcjellë kryetarin e shoqatës. Mua po më intereson të di që këta 72 punëtorë që nuk janë as në pension dhe të papunë, prej cilit vit janë, a kanë punuar diku gjatë këtij intervali? Këta në këtë moshë ende nuk i paskan mbushur 50 vjeç! Në atë kohë kanë qenë 34 vjeç, pra është një moshë vitale, një kohë që kanë mundur të japin kontribut. Kurse sa i përket kontrolleve shëndetësore, a jeni marrë vesh paraprakisht me Ministrinë e Shëndetësisë?

Naser Avdiu - Këta janë të pa punë qysh nga largimi nga masat e dhunshme prej 1989, deri më tani. Në bazë të udhëzimit administrativ, me përfundimin e luftës, të gjithë minatorët që kanë qenë të punësuar diku mbi 4000, këta kanë pasur vende punë, por për shkak se nuk ka kapacitet "Trepça" për të gjithë punëtorët që kanë punuar aty në të kaluarën, sepse nuk janë duke punuar të gjitha filialet. Po ashtu, kemi bërë marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë. Ne jemi shoqatë sindikale në nivel nacional. Vetë minatorët e kanë themeluar, pasi që deri në vitin 2005, janë shkelur shumë të drejtat e minatorëve.

Kryetarja – Atëherë, kjo pikë mbaroi, më lejoni t’ju falënderoj. Ne si Komision, shqetësimet e juaja do t’i adresojmë tek ministritë përkatëse dhe do t’i shqyrtojmë mundësitë e tejkalimit të këtyre vështirësive për pensionistët e Trepçës. Ju faleminderit!

4. Takim me Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-MPMS z. Arban Abrashi. Temë diskutimi: Zbatimi i Ligjit nr. 04/L-131, për Skemat pensionale të financuara nga shteti

Kryetarja – Mirëserdhët!

Fillimisht, më lejoni t’ju falënderojmë që iu keni përgjigjur ftesës së Komisionit për raportim. Atëherë, po ju informojmë se paraprakisht kishim përfaqësuesit e pensionistëve të kombinatit “Trepça”, të cilët para nesh prezantuan kërkesat dhe problemet që po ballafaqohen pensionistët e Kombinatit “TREPÇA”. Andaj, ne ju kemi ftuar ju, që të diskutojmë lidhur me zbatimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, me theks të veçantë, se si po zbatohet ligji për pensionet e parakohshme të minatorëve, që lidhet me çështjen e skemave pensionale të financuara nga shteti. Ne morëm informatën nga përfaqësuesit e pensionistëve të Kombinatit “Trepça” se 72 punëtorë të cilët më herët, në bazë të marrëveshjes së UNMIK-ut, ish- punëtorët e Trepçës e kanë gëzuar këtë të drejtë të pensionit të parakohshëm, ndërsa me ligjin e ri tani nuk e gëzojmë këtë drejtë, se nuk i plotësojnë disa kriteret.

Arban Abrashi – Faleminderit shumë kryetare!

Të nderuar të pranishëm dhe media, sa i përket çështjes së pensioneve të parakohshme të Trepçës, është një temë që e kemi trajtuar me seriozitet, posaçërisht për shkak të specifikave. Është e vërtetë që këta kanë pasur të drejtë në pension, por me kalimin e ligjit, një numër të përfitueseve, për shkak të moshës, u është ndalur tani. Ne si ministri dhe si kabinet, jemi ballafaquar me një pozitë pak të palakmueshme. Siç e dini, ligji është shumë rigoroz dhe nuk lë shumë hapësirë për këto familje dhe më e keqja është një numër shumë i vogël i përfitueseve. Ne, bashkë me Departamentin ligjor dhe të pensioneve, jemi duke u përpjekur të gjejmë mënyra se si t’i fusim këta përfitues në skemë. Pasi që është një e drejtë e fituar më herët, është jo e natyrshme të largohen nga kjo e drejtë që e kanë fituar më herët. Sidoqoftë, ligjin e kemi. Ose duhet të fillohet procesi i ndryshimit, ose të gjejmë forma të tjera kreative. Një prej formave që e kemi diskutuar me zyrën ligjore dhe menaxhmentin e Trepçës, shumë të shpejtë do të kemi suksese të arrijmë një marrëveshje. Ne si ministri dhe menaxhmenti i Trepçës, dy organizatat buxhetore të ndajmë një fond të vogël, i cili është i përballueshëm për të dyja dhe të bëjmë pagesën e këtyre që kanë mbetur jashtë. Kjo është një zgjidhje kreative dhe lehtë e përballueshme edhe prej anës sonë. Ne i kemi zhvilluar të gjitha procedurat brenda ministrisë, nuk e kemi problem ndarjen e një fondi mbi 10.000 deri 20.000 euro, mund të bëjmë kursime diku dhe ligjërisht përmes marrëveshjes me Trepçën të bëjmë pagesën. Ne i kam takuar disa herë, edhe departamenti i pensioneve po ashtu, nëse nuk gabo, 20 prej tyre e përfitojnë të drejtën e pensionimit brenda këtij ligji në korrik dhe do të lirohemi prej 20 përfitueseve. Marrëveshja është lehtë e zbatueshme dhe nuk ka implikime aq të mëdha, se nëse hyjmë në ndryshime ligjore, merr kohë nëpër komisione, qeveri. Ne kemi treguar gatishmërinë se mund të gjejmë fonde, edhe pse është vështirë. Ju e dini se në ministri 99.9 % janë të parapara më herët, të cilat ne i menaxhojmë, por besojmë se mund të arrijmë të kursejmë në disa kategori, në mënyrë që të gjejmë që këta të mos mbesin jashtë skemës. Pres që javën e ardhshme ekipi ta vizitojë Trepçën. Me draftin e parë të marrëveshjes, obligimet që mund t’i marrin ne dhe çka munden ata, që të realizohet kjo e drejtë e tyre.

Kryetarja - Faleminderit, ky qenka një lajm i mirë, paska qenë e nevojshme t'i ndalim minatorët këtu dhe ta dëgjojnë.

Shukrije Bytyçi - Faleminderit kryetare, përshëndetje për ministrin, kryeinspektorin dhe përfaqësuesin e zyrës ligjore. Të gjithë e dimë kontributin e minatorëve, desha të pyes rreth çështjes së pensionit të arsimit në vitet e 90-ta, e di që është e rregulluar me ligj, por ata nuk i gëzojnë të drejtat e tyre të pensionit të atyre që ju takojnë edhe mësimdhënësit e kanë dhënë kontributin e tyre të çmueshëm në vitet 90-ta, nuk e kanë lënë arsimin shqip, kanë pasur shumë sfida, mandej kemi një numër të madh të mësimdhënësve që janë në pension, janë në kushte të vështira ekonomike dhe shëndetësore. Kisha dashur të di se deri ku kanë shkuar këto procedura? E di që me ligj është rregulluar, por e realizueshme deri më tani nuk është.

Arban Abrashi - Kjo pjesë e ligjit, gjithashtu edhe dy skemat e kaluara, edhe kategorizimi nënkuptojnë miratimin e disa rregulloreve të brendshme ose ndërtimin e infrastrukturës ligjore, për të pasur më të qartë implementimin e kësaj skeme, për vetë ata të dihet se kush ka punuar, si duhet dokumentuar atë, cilat janë materialet të cilat duhet t'i përshpejtojnë, por njëkohësisht edhe për neve që t'i largojmë të gjitha dyshimet e mundshme që mund të jenë, se cilat dokumente kërkojnë kur dikush e dëshmon përvojën e punës. Departamenti është duke punuar në hartimin e kësaj kornize ligjore në konsultim me të gjitha grupet e interesit, proceset janë në zhvillim në ndërtimin e procedurës së nevojshme për këto kategori të mësimdhënësve.

Kryetarja- Sa akte nënligjore janë nxjerrë deri më tani dhe sa po presin të nxirren? Ligji e parasheh që për 6 muaj duhet të nxirren, pra shumica është dashur të nxirren.

Arban Abrashi - Janë 5 akte nënligjore të cilat janë duke u punuar. Akti i parë, draft- udhëzimi administrativ për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensioneve kontributdhënësve. Jemi duke punuar në bazë të formulave të ndryshme dhe kemi takime të ndryshme me përfaqësuesit e pensionistëve. Ka ide të shumta si duhet të jetë kategorizimi. Realisht, nuk është lehtë, sepse kërkesat janë të mëdha, ndërsa mundësitë buxhetore janë të vogla. Kam pasur vetë takim me ministrin e Financave dhe kemi diskutuar se si mund ta gjejmë mënyrën për t'i gjetur këto fonde. Jemi duke bërë analizat për tri skemat, për kategorizimin, për ligjin për pensione invalidore dhe familjare. Kostoja mund të jetë mbi 20 milionë euro, ndoshta edhe më shumë. Kam bërë kërkesat që në rishikim të bëhet ndarja e këtyre mjeteve, ndoshta edhe mund të arrijmë t'i finalizojmë marrëveshjet, por gjithashtu jemi duke shikuar edhe modele tjera tek skemat pensionale në rajon. Siç e dini, pensionet që jepen nga shteti janë ngarkesë e madhe për buxhetin shtetëror. Rajonet kanë formularë të ndryshme që punëdhënësi dhe punëmarrësi të participojnë në trustin pensional me një përqindje. Pra, është një ide që jemi duke e diskutuar, si mundësi e krijimit të fondit pensional, ku gjenerata e paguan gjeneratën. Gjithashtu, edhe shteti ndërhyr me buxhet. Kjo është pjesa e parë dhe jemi duke punuar tek ky draft-udhëzim administrativ. Gjithashtu, jemi duke punuar edhe në procedurat e aplikimit dhe ankimit për skemat pensionale. Jemi duke punuar me shtete të tjera për të lidhur marrëveshje që t'u njihet përvoja dhe kontributi qytetarëve në shtete të tjera. Në të njëjtën kohë jemi duke punuar për t'i ndryshuar procedurat e aplikimit për pension të moshës, sepse ashtu siç janë procedurat, çdokush që ka 65 vjet, ka të drejtën e pensionit të moshës, edhe qytetarët tanë që nuk jetojnë në Kosovë, pra nuk janë rezidentë, përfitojnë pensionin e moshës dhe po e ngarkojnë buxhetin. Duke qenë rezident në shtete tjera, po përfitojnë edhe atje pensione. Jemi duke analizuar mundësitë dhe kemi disa opsione që të mos e ngarkojmë buxhetin me këta qytetarë që mërin pensione në shtetet ku jetojnë. Udhëzimi i tretë është për njohjen e së drejtës për të qenë invalid i punës, është diçka që po punohet.

Udhëzimi i katërt, procedura për kthimin e mjeteve në rast të keqpërdorimit të pensioneve dhe draft- udhëzimi i fundit, procedura për aplikimin dhe vlerësimin për pensionet e paafëtisë.

Time Kadrijaj- Faleminderit ministër që keni pranuar ftesën, e sqaruat mirë këtë problemin që është më ish-punëtorët e Trepçës. Ishim një ditë në takim me sindikalistët e arsimit. Ata po thonë se nuk po iu paguhet stazhi që iu takon me ligj, periudha e viteve 90-99. Ne gjatë amendamentimit kemi kërkuar që të njihet ajo periudhë edhe për punëtorët e arsimit dhe punëtorët shëndetësorë. Në çfarë rrethane kanë punuar në sistem paralel në shëndetësi dhe në arsim, patjetër duhet t'u njihet ajo periudhë e përvojës së punës.

Gjithashtu, nenet që deri më tash nuk kanë filluar të zbatohen, janë nenet për pensionet invalidore dhe pensionet familjare. Kur do të fillojnë të zbatohen? Më intereson edhe se çka u bë me pensionet e Zvicrës? Në mandatin e kaluar është zhvilluar një debat parlamentar për pensionet me Serbinë, është kërkuar që të formohet një komision ndërqeveritar, i cili do të merret me çështjen, që të punësuarve dhe pensionistëve t'u mundësojë që në mënyrë institucionale, qoftë në kompletimin e dokumentacionit apo qoftë edhe me bisedime, që të kthehen pensionet e shqiptarëve që janë në Serbi.

Meqenëse kemi këtu kryeinspektorin, e pyes se çka u bë me rastin e RTK-së me suspendimin e disa sindikalistëve dhe krye sindikalistëve?

Ky ka pasur të raportojë më herët, por nuk e ka bërë, tani po e shqyrtojmë rastin.

Kryetarja- Çështjen e kryeinspektorit do ta diskutojmë në fund. Është një temë që do ta zgjidhim bashkë me ministrin. Kryeinspektori ka pasur të raportojë dhe nuk ka raportuar, sepse ka menduar që nuk mundet pa lejen tuaj ministër, kjo është diçka që ne nuk jemi pajtuar, le ta kuptojë se do të na raportoj neve njësoj sikur juve.

Arban Abrashi - Punonjësit e arsimit, shëndetësisë, jemi duke punuar në atë drejtim dhe rreth nxjerrjes së kostos për këto kategori. Këtë e thashë edhe më herët dhe shpresoj që shpejt të arrihet. Informatat janë të mangëta, ndërsa ideja është që mos me ju premtuar njerëzve, nëse i aprovohet që ka punuar, e mandej të dalë që nuk kemi kosto. Duhet të kemi një formë unike se çfarë kërkohet prej tërë sistemit. Jemi duke ndërtuar infrastrukturën ligjore dhe po merr kohë, për bazë e kemi marrë një vendim të Qeverisë para dy javësh, si model se çka kërkohet për njohjen e përvojës së punës. Kjo ka të bëjë më shumë me sektorin publik, por ka shërbyer si bazë e mirë, pasi që Ministria e Administratës Publike ka investuar një kohë të gjatë të gjejë se cilat janë ato dokumente, prej librezës së punës, përvojës së punës, prej kontributeve kudo që ka dhënë prej pagës. Pasi që të kompletohet kjo infrastrukturë ligjore, t'i bëjmë kalkulimet, aplikojmë ose kërkojmë fonde, pasi që fondet nuk janë të parapara në buxhetin e sivjetshëm. Realisht, kemi dy skema të reja pensionale dhe një kategorizim, i cili nuk është përcjellë me buxhet. Është shumë problem si ministri për të premtuar apo zotuar mjete, pasi që ato mjetet nuk ekzistojnë. Ka një nen të financat publike që e lejon që ne t'i paguajmë me zotimin e mjeteve, por ideja jonë është të përfundojmë infrastrukturën ligjore dhe t'i kërkojmë mjetet, mundësisht në rishikim. Tek pensionet e Zvicrës, mendoj se zhvillimet janë të mira. Ne kemi dorëzuar pyetësin e parë në vitin 2014, kemi trokitur në zyrën e ambasadës së Zvicrës dhe takimet kanë qenë të mira. Ne e kemi marrë pyetësin e dytë, nëse nuk gabojmë është dorëzuar në fund të muajit mars apo fillim të muajit prill dhe për këtë kam raportuar në Kuvend. Mbas një muaji, nga Zvicra prapë kemi marrë pyetje shtesë dhe iu kemi përgjigjur. Po ashtu, kemi marrë edhe obligime shtesë për të treguar seriozitetin e Qeverisë. Besoj që javën e ardhshme, ne si ministri, i nënshkruajmë dy marrëveshje të cilat pastaj i dërgojmë tek ambasada e Zvicrës. Këto marrëveshje kanë të bëjnë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku neve si ministri na jep qasje në regjistrin civil, në mënyrë që të kemi kontroll rreth vdekjeve. Gjithashtu, ne do të bëjmë marrëveshje me bashkësitë fetare në Kosovë, do t'i pajisim ata me teknologji informative, ku do të kemi të dhënë direkte kohore të rasteve të vdekjeve që ndodhin në Kosovë. Këto i kemi marrë si obligime shtesë, për të treguar seriozitetin tonë ndaj shtetit të Zvicrës. Me këto dy marrëveshje do të kemi qasje në regjistrat civilë dhe regjistrat e bashkësive fetare në Kosovë, shpresoj se do t'i dorëzojmë javën e ardhshme. Me

këto, ne i kryejmë obligimet që i kemi ndaj shtetit zviceran. Tash të shohim sesi do të lëvizin ata. Kemi filluar negociatat fillestare, pa hyrë në detaje me shtetin e Austrisë, përmes ambasadës. Presim që të mbarojë marrëveshja me Zvicrën, pastaj të njëjtin model ta përdorim edhe në shtetin e Austrisë. Për korrektësi, ne kemi kërkuar që të shkojmë vetëm në disa komuna si pilot- projekt disamujorë, mandej të zbatohet në gjithë Kosovën.

Kryetarja-Sa marrëveshje janë nënshkruar deri më tani me shtetet tjera, sepse ka disa, dhe me cilat shtete?

Problemi i pensioneve është mjaft serioz , sepse këtu qytetarët e Kosovës të komunitetit serb, marrin nga dy pensione, nga Serbia, por edhe nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Arban Abrashi – Kemi marrëveshje me Maqedoninë dhe me Malin e Zi, ndërsa me Shqipërinë jemi në negociata. Sipas praktikave më të mira, ne i kemi udhëzuar edhe përkrahur shoqatat e pensionistëve në mënyrë institucionale me material të nevojshëm se si të aplikohet dhe cilat janë mënyrat më të mira ligjore që duhet ndjekur. Është angazhuar një ekip i avokatëve të huaj, ka zhvillime, por ndoshta nuk është koha të flasim tani, por ka zhvillime serioze. Në Serbi është e rregulluar. Një qytetar i Serbisë, i cili jeton jashtë, nuk ka të drejtë të marrë pension në Serbi.

Njomza Emini- Faleminderit kryetare!

Fillimisht, ministër ju përgëzoj për iniciativat dhe një menaxhim shumë të mirë prej që e keni marr detyrën. E kisha një pyetje për akte nënligjore, por ju veç e sqaruat. Do të doja të ju pyesja juve zoti Basri Ibrahim, sa i përket inspektimeve në shumë kompani private. Unë faktikisht udhëtoj edhe me taksit dhe shoferët më kanë treguar që nuk kanë kontrata. Besoj se edhe juve kolegë ju ka rastisur që punëtorët e shumtë tek pastrimi i objekteve, tek restorantet, nuk kanë kontrata. Sa janë inspektuar deri më tash, si qëndron puna me këto kontrata, se shumë shoferë paguheshin kështu në 10 kompani, sa kemi ne dhe të na informoni se si qëndron puna me këta punëtorë pa kontrata?

Basri Ibrahim- Faleminderit, fillimisht dëshiroj t'i përgjigjem zonjës së nderuar për pyetjen që e shtroi. Unë nuk kam ardhur të raportojë, për shkak se procedura duhet të shkojë ndryshe, jo të vijë drejtpërdrejt këtu. Edhe pyetjet parlamentare të cilat i dërgohen ministrit, duhet të shkojnë përmes sekretarit të Qeverisë. Mendoj se kjo procedurë duhet sqaruar. Jam i bindur se procedura për të raportuar kryeinspektori në Komisionin parlamentar, pavarësisht unë apo dikush tjetër, duhet të shkojë përmes ministrit, derisa nuk sqarohet procedurë tjetër.

Time Kadrijaj- Ti duhet t'i përgjigjesh ftesës sonë, pastaj ta informosh ministrin.

Basri Ibrahim-Nuk është çështja vetëm për të informuar ministrin, natyrisht e informoj se këtë e kam shëf dhe i raportoj ministrit për të gjitha, por mendoj që të mësohemi me respektimin e procedurave. Në qoftë se i respektojmë procedurat, atëherë jemi të gatshëm çdo ditë t'ju raportojmë.

Time Kadrijaj- Edhe ministri atëherë u dashka të kërkojë leje prej kryeministrit që të raportojë në Komision.

Basri Ibrahim- Vendim ne e kemi marrë dhe punëtorët e RTK-së të cilët janë suspenduar, faktikisht iu ka ndërprerë kontrata. Ata janë kthyer në vendin e punës. Vendimi i Inspektoratit të Punës është se, vendimi për suspendimin e punëtorëve të RTK-së është i pa bazë, i marrë nga personi i paautorizuar. Për pyetjet e znj.Emini, ne kemi bërë shumë inspektime dhe jemi

fokusuar në fushat të cilat i konsiderojmë që janë më të ndjeshme, që zbatimi i Ligjit të punës dhe Ligjit për siguri në punë, si dhe ligjet tjera, janë më pak të zbatueshme. Besoj që jeni në dijeni se kemi zhvilluar gjatë prillit një fushatë vetëdijësuese. Deri në qershor kemi një fushatë më intensive të inspektimeve, të fokusuar kryesisht në dy pika kryesore: çështja e kontratës së punës dhe pajisjeve personale mbrojtëse. Çështja te pajisjet personale mbrojtëse nga aspekti i Ligjit për siguri dhe shëndet në punë, është pika më e vogël se aty kemi shumë çështje të tjera që lidhen me shëndetin dhe sigurinë në punë. Ne kemi konsideruar se në qoftë se arrijmë që pajisjet personale mbrojtëse t'i imponojmë në mënyrë të plotë, atëherë punëdhënësi do të vetëdijesohet, nga ana tjetër pajisjet personale mbrojtëse shihen me sy dhe është shumë më e lehtë për t'u evidentuar edhe prej syrit të qytetarit, mediave dhe të gjithë neve. Për punëtorët pa kontrata pune, ne kemi shkuar, sepse procedurat e Inspektoratit të Punës janë që fillimisht t'i inspektojmë, t'i konstatojmë të metat dhe dhënien e kohës së duhur për eliminimin e atyre të metave. Nëse nuk eliminohen, atëherë t'i shqiptohet gjoba. Arsyeja pse e kemi përcaktuar këtë politikë është për shkak se kompanitë e kanë kuptuar këtë koncept. Ata kanë thënë se po i mbajnë punëtorët pa kontrata pune, për arsye të mospagimit të trustit pensional dhe tatimit në pagë, dhe kur vjen Inspektorati i Punës, e bën inspektimin, na jep kohë dhe ne atëherë i pajisim me kontrata. Ne kemi konsideruar që kjo më është e patolerueshme. Në vitin 2014, ne kemi hasur 2700 punëtorë pa kontrata pune. Nëse e marrim me përqindje, numrin e punëtorëve që janë marrë në inspektime, ka qenë diku 36 mijë punëtorë, nuk është ndonjë shifër alarmantë siç paraqitet në media dhe qarqe të tjera, por megjithatë edhe 7 apo 8 % është shumë. Ne do të mundohemi maksimalisht që pikën pa kontrata pune, ta heqim prej rendit të ditës, sepse në radhë ajo është çështje bazike që punëtori që nuk ka kontratë pune është problem që t'i kërkojmë mbrojtjen e të drejtave të tij që i garanton Ligji i punës, por edhe Ligji për siguri në punë. Kjo formë e inspektimeve për këto çështje po vazhdon dhe do ta bëjmë një raport që do ta keni edhe ju, edhe opinioni publik se cilat kanë qenë rezultatet e punës sonë. Kompanitë e pastrimit janë vende më të ndjeshme, jo vetëm për kontrata, por për shkak të pagave, fatkeqësisht po hyjnë në institucione shtetërore nëpër tenderë, duke e marrë me çmime të ulëta, pastaj ata nuk po mund t'i mbulojnë shpenzimet e tyre. Ne kemi konsideruar që ndoshta prokurimi është dashur ta ketë parasysh për të mos lejuar nën pagën minimale, në asnjë mënyrë të mos jepet asnjë tender. Kemi shqiptuar shume gjoba ndaj këtyre kompanive, por nuk kemi arritur t'i vetëdijësojmë. Ne kemi bërë punën tonë, mundësi tjetër nuk kemi.

Arban Abrashi - Edhe Inspektorati i Punës i ka problemet e veta dhe e ka të pamundur për të mbuluar tërë territorin e Kosovës. Këta e kanë një plan të punës, bazuar në analiza dhe risk se ku duhet t'i bëjnë inspektimet, dhe sa herë t'i bëjnë, sidoqoftë është shqetësues numri i inspektorëve të cilin e kam gjetur. Kam tentuar për të rritur numrin e inspektorëve. Realisht, struktura e ndërtuar në disa rajone i lejon pak hapësirë për të punuar, sepse në disa komuna nuk ka inspektorat dhe është e pamundur një komunë me zero inspektor, ta përfundojë këtë punë. Jemi duke shikuar mundësitë që inspektorati të punojë në dy ndërrime dhe mendoj që është shumë i rëndësishëm një element që u përmend më herët tek zero tolerancë, sepse mund të tingëllojë shumë keq, ndoshta mund të kritikohemi nga mediat që po dënojmë, por nuk është ideja për të dënuar. Ekziston një ndërlidhje të cilën po e hasim tek skemat e asistencës sociale ku një numër të tyre edhe kur u ofrohen kontrata pune prej një punëdhënësi, shpeshherë i refuzojnë ato, sepse e humbin të drejtën e asistencës sociale. Kjo është e rrezikshme, në qoftë se ne mendojmë ta rrisim kompensimin e asistencës sociale, sepse kemi instaluar një softuer i cili në bazë të njoftimeve të shikojë nëse dikush ka edhe të hyra të tjera dhe nëse nuk gabo, prej fillimit të vitit kemi kursyer afërsisht 2 milionë euro. Puna është e ligjshme dhe është e drejtë e secilit të punojë, por jo e pa deklaruar. Jemi duke u mundur për zbulimin dhe ndalimin e punëtorëve pa kontrata pune. Gjithashtu, jemi duke u mundur për të zhvilluar një mënyrë që të bëhet regjistrimi online i

punëtorëve drejtpërsëdrejti nga punëdhënësi, që atëherë ai nuk do të ketë asnjë mënyrë që të arsyetohet që nuk ka pasur kohë apo nuk ka mundur.

Fikrim Damka-Faleminderit, përshëndetje për ministrin dhe stafin e ministrisë. Unë nuk do të ndalem te inspektorati, sepse shumë tema do të hapen për ligjin e punës, inspektimin e ligjit të punës etj. Për kontrata mund të fillohet prej vet Kuvendit që këta që shërbyen, nuk kanë kontrata të punës. Këta duhet kontrolluar dikush, e ju jeni inspektorati. Dua të ndalem te Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti, neni 8, pika 1.2 dhe 1.3, ku kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës së pensionit kontributdhënës të moshës, të paraparë te pika 1.2, hapet një rrugë e cila është e pakufi dhe nuk mund të besoj se mund ta mbulojë buxheti. Ka qenë shumë diskutabil gjatë miratimit në Kuvend, nuk e ka marrë formën prej Komisionit, por e ka marrë dritën e gjelbër nga Kuvendi, nuk e kanë analizuar mirë që ka hapur shumë dyer dhe besoj që nuk mund të mbulohet nga buxheti. Si do të mbulohen këto ministër?

Arban Abrashi - Një prej kërkesave për të arritur të drejtën e pensionit është edhe tani. Besoj se me udhëzime administrative, ne e kemi përkufizuar dhe kjo funksionon dhe nuk shohim problem.

Sami Salihu -Një prej skemave është edhe pensioni bazë kontribuues. Fjala është për ata të punësuar që kanë punuar para vitit 1999, d.m.th. të cilët kanë paguar kontributin për sigurimin pensional dhe invalidor. Është e drejtë e tyre në pension, sepse në njëfarë mënyre, është pronë e tyre, sepse ata prej pagës së vet kanë ndarë kontributet. Atëherë ka qenë një sistem unik në nivel të ish-Jugosllavisë. Pra, ka qenë në harmoni me atë dhe në bazë edhe të atij ligji të mëhershëm, është kërkuar e drejta në pension, që të jenë së paku 15 vite përvojë pune. Edhe tash, si në ligjin e mëhershëm, parashihet që të jenë së paku 15 vite përvojë pune në periudhën kur kanë paguar kontribute. Edhe në rajon, është kjo periudhë 15 vjet, kurse mbas '99-ës është trusti pensional ku ka obligim secili i punësuar t'i ndajë 5 % dhe punëdhënësi 5 % , kanë të drejtë deri në 30 % në baza vullnetare, kur t'i bëjë 65 vjet, mund t'i tërheqin. Një prej pikave në këtë nen është pranimi i stazhit në atë periudhën para vitit '99 . Jemi duke punuar rreth draftimit dhe me çfarë dokumenti duhet identifikuar dhe faktuar. Është edhe një tjetër aspekt që u përmend më herët se me ndryshimin e dispozitave të draft- ligjit të mëhershëm se këto 4 kategori, kategorizimi i tyre dhe pranimi i stazhit të periudhës 1989-1999, këto pensione familjare dhe invalide të hyjnë në fuqi, prej datës 01.01.2016, ka kaluar prej Qeverisë, po në Kuvend është vendosur që të hyjë në fuqi prej vitit 2015. Kjo ka bërë që të ndryshohet kostoja e implementimit të këtij ligji, prandaj për këto 4 skema nuk janë lejuar mjete për këtë vit.

Besa Baftiu- Faleminderit, përshëndetje për ministrin, për kryeinspektorin dhe drejtorin e Departamentit Pensional. Edhe pse shumica e pyetjeve që pata u bënë nga kolegët paraprakisht, prapë isha lidhur te Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti. Dihet që po bëhen tash 1 vit që është miratuar, mirëpo kanë filluar të zbatohen ato nene të këtij ligji që i konvenojnë vetëm Qeverisë, sepse paraprakisht biseduam për pensionet e Trepçës, p.sh. neni 10, pika 2.3 ka filluar të zbatohet. Obligimet që kanë qenë në nxjerrjen e akteve nënligjore brenda 6 muajve nuk i keni nxjerrë. Kjo po ndodh çdoherë, aty ku po i konvenon Qeverisë për të përfituar po vepron. Aty ku është për të mirë të qytetarëve po stagnon. Pagesa e stazhit e dimë se ka filluar të paguhet 0.5% i punës, por ne jemi në dijeni që nuk ka filluar te punëtorët që punojnë në kompani private. Po ashtu, këtyre punëtorëve nuk iu paguhet edhe trusti pensional. Kompanitë janë private dhe punëdhënësi i tyre është kompania publike, pra duhet të mbikëqyren. Pyetja tjetër, po më intereson të di për pensionet kontributdhënëse për punëtorët që kanë punuar deri në vitin '99, e dimë se këto kontribute gjenden në Serbi, çka është punuar në këtë drejtim, a është shtruar si temë apo do të shtrohet në bisedimet në Bruksel? Pyetje tjetër është për organizatat e huaja që

janë në Kosovë. E di se me ligj nuk parashihet t'i mbikëqyrni p.sh. KFOR-n, të cilët punësojnë punonjës prej '99-ës dhe nuk u paguajnë trustin. Faktikisht nëse ata punëtorë dalin në pension ose largohen nga puna, ata mbesin pa dëmshpërblim. Këtu është e rëndësishme të dihet a keni planifikuar të keni një marrëveshje me këta, se është një numër bukur i madh që kanë punuar edhe ende vazhdojnë të punojnë, jo vetëm në këtë organizatë, por edhe në organizata të tjera.

Arban Abrashi -Ideja është të bëjmë maksimumin për të gjitha kategoritë dhe duke mos politizuar çështjen. Ne reagojmë në bazë të mundësive që kemi, nuk e anashkalojmë një grup në dobi të grupi tjetër. Te pensionistët e Trepçës, janë në numër më të vogël dhe lejojnë mundësi ligjore dhe financiare pa ndërhyrjen e Qeverisë, Ministrisë së Financave apo Kuvendit, të veprojmë, derisa të skema kontributdhënëse dhe dy skemat e reja, është një ligj të cilën jemi të detyruar për ta zbatuar, por kemi aty edhe hapësirë, që e ka koston afërsisht 30 milionë euro. Derisa ne nuk i kemi ato financa, ne po i përgatitim punët, pra udhëzimet administrative dhe implikimet tjera prej këtij ligji dhe implementimin e këtyre skemave teknikisht dhe pastaj do të bëjmë kërkesë në Ministrinë e Financave, që të shqyrtohet.

Besa Baftiu- Kryeministri Mustafa në fushatë ka premtuar që do t'i bëjë pensionet 183.50 euro, pra 64 % të rritën.

Abran Abrashi - Këtë buxhet e kam trashëguar, aty ku po mundemi po lëvizim. Ne do të kontribuojmë duke kursyer tek kategoritë tjera. Tek pensionet dhe dialogu është diçka që na ka shqetësuar si temë dhe jemi munduar që ata të cilët po merren me dialog, që edhe kjo të jetë një prej temave. Agjenda e dialogut për momentin caktohet nga Brukseli, por është kërkesë e ministrisë dhe besoj që ka për të hasur në mirëkuptim. Në të njëjtën kohë, ne kemi reaguar dhe kemi angazhuar një zyrë ligjore që i përkrah në ndjekjen e këtyre zhvillimeve dhe të drejtave që iu takojnë. Tek pagesa e përvojës jemi fokusuar te sektori publik dhe është e vërtetë, ka kaluar vendimi në Qeveri para 3 javësh. Ne si ministri dhe të gjithë organizatat tjera buxhetore e kanë marrë këtë vendim dhe kanë kërkuar nga njësia e burimeve njerëzore që secili zyrtar që punon në sektorin publik t'i sjellë dokumente përkatëse që e dëshmojnë përvojën e punës. Te sektori privat është një ligj i cili aplikohet dhe është kontrata kolektive. Realisht, përpos që kërkon prej sektorit privat t'i obligojë dhe t'i paraqesë kushtet, gjithashtu i lejon fleksibilitet sektorëve të ndryshëm të organizuar brenda unioneve të vendosin se a mund të aplikojnë një nen të caktuar.

Basri Ibrahim- Për çështjen e kompanive private që kryejnë shërbime për kompani publike, aty kryesisht janë dy aspekte. E sqarova edhe më herët, që kompanitë publike duhet t'i mbikëqyrë, sepse atyre iu kryejnë shërbim dhe ata duhet shikuar se si trajtohen punëtorët e vet. Por, sido që të jetë, ne si Inspektorat i Punës e kemi për obligim t'i mbikëqyrim. Ne i mbikëqyrim se sa kompani private po e zbatojnë ligjin e punës ndaj punëtorëve të vet. Kontratën e punës dhe raportin punëdhënës- punëtor e mbikëqyrim ne, ndërsa raportin që është një raport tjetër ndërmjet punëdhënësit- punëtor, të cilën e kemi quajtur sipërmarrës është raport kontraktual ndërmjet kompanisë private dhe publike, është jashtë fushës së Inspektoratit të Punës. Ata kanë raportin e vet se nëse nuk respektohen mund t'i ndjekin rrugët e tjera gjyqësore. E thashë edhe më herët, edhe ne nuk jemi të kënaqur me kompanitë e sigurimeve fizike dhe të pastrimit dhe kemi shqiptuar shumë gjopa, por në pamundësi, pasi ne nuk kemi mundësi të tjera shtrënguese, shkojmë me gjopa.

Kryetarja-Çdo ligj që aprovohet në Kuvendin e Kosovës e ka për detyrë ta japë edhe aprovimin financiar. Ne nuk kemi votuar symbyllazi, por e kemi ditur që ekziston buxheti, por nuk e di ku janë dërguar ato mjete. Kam një pyetje tjetër që nuk është ligjore, por humane. A i shihni

pensionistët që çdoherë duhet të deklarohen se janë gjallë, a nuk është pak përbuzëse kjo për njeriun? Meqenëse këto të ardhura paguhet përmes bankave, atyre iu ndalen 1 euro. Për të shkuar për të marrë pensionin prej 75 euro, pensionisti në pamundësi duhet të paguajë 5 euro për taksë, shumica nuk mund të vozisin dhe nuk kanë kushte.

Sami Salihu - Me ligj thuhet se 2 herë në vit duhet të lajmërohen personalisht pensionistët. Në shtetet e perëndimit nuk kanë obligim të lajmërohen një herë në vit, këtë e dëshmojnë në bazë të certifikatës së mjekut. Edhe tek ne lëshojmë certifikata të mjekut, mirëpo për arsye të njohura nuk i paraqesin rastet e vdekjes, mirëpo ka raste kur i paraqesin vetëm kur kanë për të trashëguar diçka. Para disa muajve, në shtyp ka shkruar se Departamenti i Pensioneve paguan pensione edhe 5 vite mbas vdekjes. Mundohemi që t'i hulumtojmë, por është shumë problem. Ne tani i kemi obliguar edhe personat me aftësi të kufizuara që të lajmërohen. Ato raste që nuk kanë mundësi për t'u lajmëruar, personalisht mund të lajmërohen me një telefonatë dhe ne shkojmë në vendin e ngjarjes me konstatuar që është gjallë. Për atë që the nga 1 euro, nuk është e saktë, për arsye se llogaritë i hapim ne vetë dhe i menaxhojmë, edhe shpenzimet i paguajmë dhe nuk kanë provizion. Iu kemi mundësuar edhe kartelë për bankomatë, nuk kanë obligim me paguar për kartelë.

Shukrije Bytyçi- Disa ofiqari nuk japin certifikatë që është gjallë, por duhet shkuar përmes noterit, ndërsa një shërbim të noteri kushton 5 euro, për të dëshmuar që është gjallë. A dallojnë këto në komuna tjera? Sepse, diku japin certifikatë, më herët kanë dhënë dhe ka kushtuar 1 euro, tani nuk japin ofiqarët.

Sami Salihu - Ne certifikata mbi jetën nuk kërkojmë, duhet personalisht me u lajmëruar ose përmes të autorizuarit. Kjo taksë është ndoshta ndonjë prej të hyrave komunale.

Besa Baftiu-Unë nënën e kam pensioniste dhe nuk paguhet kjo shumë .

Kryetarja- Sa i përket rastit të kryeinspektorit , besoj se këta duhet ta zgjidhin në mes vete se kujt i merr leje por ai duhet ti përgjigjet ftesës së Komisionit.

Po i bashkëngjitem shqetësimit për zbatimin jo vetëm të ligjit për skemat pensionale por edhe Ligjit të punës. Jo vetëm punëtorët e pastrimit , ka edhe shumë punëtor tjera në ndërtimtari, në ndërtimin e rrugëve, që në orët e natës ku ndoshta inspektorët nuk punojnë, kam vëzhguar se punojnë natën nga 12 ora, në ndërtimin e rrugëve dhe në çfarë kushte punojnë është katastrofë, dhe pa pagesë shtesë. Në vetëshërbime të pompave të benzinës punojnë gra me fëmijë të vegjël, për shkak se punëdhënësi nuk donë ti ketë 3 punëtor që të punojnë nga 8 orë por më pak që ti shfrytëzon në maksimum.

Ne duhet të diskutojmë se si mund të gjejmë zgjidhje dhe a mund të shtojmë numrin e inspektorëve apo të shtojmë oraret, apo ta ndryshojmë ligjin që të jeni më të fuqishëm, që aty për aty t'i shqiptoni gjokat për shkelësit, ndoshta edhe ligji duhet të jetë më rigoroz.

Basri Ibrahimi-Ne jemi plotësisht të vetëdijshëm për gjendjen e respektimit të të drejtave të punëtorëve në Kosovë dhe të kompanitë ndërtimore që ju e potencuat. Çdo sezon pune, pjesën më të madhe të kohës i përkushtojmë kompanive ndërtimore dhe këtu kemi shqiptuar më së shumti gjoka. Edhe tash, në fushatën sensibilizuese, kur thashë pajisjeve personale mbrojtëse, ajo është baza për punëtorët për t'u ndjerë të sigurt në vend të punës dhe për t'u trajtuar më mirë. Ju vetë thatë numrin e vogël të inspektorëve, pagesa është e vogël, ata paguhet njëjtë sikur një zyrtar që punon në administratë, për shkak të rrezikshmërisë.

Besa Baftiu-Tek inspektorët a është konflikt interesi për me punuar në institucione private, kur dihet se ata i inspektojnë të gjithat si publike dhe ato private.

Basri Ibrahimi- Nuk është konflikt interesi, se pas orarit të punës nuk mundesh me ia kufizuar të gjitha mundësitë e tjera, sepse inspektori i mbikëqyrë të gjitha, në institucionet publike nuk mund t'i marrësh dy rroga. Në qoftë se dikush e sheh, mund të shkojë te Agjencia Kundër Korrupsionit dhe ajo e sqaron.

Time Kadrijaj-Meqenëse edhe vetë kam punuar në Inspektoratin Shëndetësor, me ligj ka qenë e rregulluar që kryeinspektori, zëvendëskryeinspektori dhe inspektorët, ka qenë konflikt interesi të punohet në institucionet private ose hapja e ndonjë ordinance.

Po e shoh se kur shpërndahen skemat sociale, pse është caktuar një periudhë vetëm prej 2 ditësh. Mua më ka ardhur keq, është shumë e turpshme mënyra se si kanë qasje ata që i marrin ato. Ata duhet shkuar dhe prituri në rend, qoftë shi apo borë. Ndihamat sociale duhet marrë në mënyrë të dinjitetshme, nëse ata nuk arrijnë t'i marrin brenda 2 ditëve, ata nuk mund t'i tërheqin më.

Pse nuk rregullohet kjo, pra ta kenë një numër të xhirollogarisë që ta marrin kur të dëshirojnë?

Sami Salihu -Kjo është e rregulluar me ligj, me akte nënligjore dhe udhëzime administrative, në kohë të caktuar bëhet llogaritja e pensioneve dhe del në llogarinë pensionale. Të gjitha pensionet rreth 200 mijë vetë të të gjitha skemave derdhen në llogarinë bankare të çdo individi veç e veç. Mund t'i marrin kur të duan ata, por është diçka tjetër për ndihma sociale, sepse vetë kuptimi se ka nevojë për ndihmë, ata e kanë obligim t'i tërheqin, por në rast se nuk i tërheq brenda muajit, atëherë do të thotë se nuk paska nevojë për ndihmë dhe i ndalet, ndërsa pensionet mund t'i marrin kur të duan.

Arban Abrashi -Jemi duke shikuar me PTK-në për të lidhur marrëveshje, se e ka rrjetin më të madh të shtrirjes, por edhe se punojnë në mbrëmje. Të shohim a na jep aprovimin BQK-ja dhe Ministria e Financave dhe ta bëjë PTK-ja shpërndarjen e pensioneve.

Shukrije Bytyçi - Cila është qasja e Inspektoratit të Punës ndaj bankave?

Siç e dimë, është larguar një numër i madh i punëtorëve nga puna.

Basri Ibrahimi - Nëse e keni shkuar emisionin “Jeta në Kosovë”, aty kam folur për këtë gjë, i kemi inspektuar, iu kemi shqiptuar gjopa shumë bankave, jo veç asaj. Ajo mënyrë sesi i ka larguar me presion dhe ka pasur raste kur i kemi obliguar për t'i kthyer punëtorët në punë. Megjithatë, duhet kuptuar bankat se janë duke e ndryshuar sistemin e vet të menaxhimit, sepse kanë nxjerrë artikuj të ndryshëm në treg dhe natyrisht ai shkon duke e shkurtuar stafin. Ne nuk mund ta obligojmë asnjë biznes privat për të mbajtur detyrimisht punëtorë, më shumë se sa që i nevojiten.

Kryetarja- Falënderoj ministrin për pjesëmarrje në mbledhjen e Komisionit dhe e ftoj për bashkëpunim të mëtejshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA

